

**AKT- THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“KRYPA”,SH.P.K.**

**Neni 1**  
**THEMELUESIT E SHOQERISE**

**1. Ermir Krypa, atësia Fran,** amësia Lule, shtetas Shqiptar, lindur në Ndrejaj, Shkodër dhe banues në Lezhë, me adresë Koder Marlekaj; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Lezhë; Lezhë; 0000; Lezhë, lindur më 05/03/1984, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033751565 dhe nr. personal 140305083L

Sot me datën **14.06.2021** kame vendosur themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “KRYPA”,SH.P.K. ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” duke firmosur kete akt themelimi.

**Neni 2**  
**EMERTIM ,FORMA DHE SELIA E SHOQERISE**

**Emri i shoqerise do te jete “KRYPA” SH.P.K** Forma e shoqerise do te jete shpk  
Adresa e sajë zyrtare eshte Bashkia Lezhe , *Qyteti Lezhe , Lagjia Beslidhja , Zyre 10 m2, pasuria nr.3/68-13,zona kadastrale 8632 ,Shkalla 1,Kati 3 , Ap.13.*  
Shoqeria do te ushroje aktivitetin e sajë ne rrethin e Lezhes.  
Ajo mund te krijoje dhe te mbylle ne Shqiperi ose jashte saj , perfaqesi apo seli të tjera.

**Neni 3**  
**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e aktiviteti te shoqerise eshte e pakufizuar.Si date e fillimit te aktivitetit te sajë do te jete data e regjistrimit ne QKB Lezhe. Aksioneret me vendim te asamblese se pergjithshme kane te drejte ta zgjasin ose ta shkurtojne kete afat.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I VEPRITARISE**

Objekt i veprimtarise se shoqerise ” **KRYPA”, SH.P.K.** është në përputhje me legjislacionin tregëtar aktual Shqiptar dhe do te jete:

Eksport-import e tregti me shumice e pakice te mallrave industrial, ushqimore, pije te ndryshme jo alkalike dhe alkalike, tekstile, pajisje elektrike dhe elektroshtepiake, hidraulike, ndertimore, tregtim te makinerive e pajisjeve dhe pjeseve te kembimit per pajisje dhe makineri, eksport-import te lendes se pare . Tregtim mallrash per vete dhe te trete. Shit- Blerje automjetesh te ndryshme , mallrash, prodokuteshm pasurise te palujtshme dhe te luajtshme . Dhenie dhe marrie me qira te pasurise te palujtshme dhe te luajtshme .  
Import-eksport, ruajtje, shperndarje, shitje me shumice e pakice te artikujve parafarmaceutik, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, bimeve medicinale, paisjesh mjeksore, -Servis dhe mirembajtje paisjesh mjeksore .

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Ortakeve.

Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.



Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj. Si dhe cdo aktivite që e lejon legjislacioni Shqiptarë .

## NENI 5 KAPITALI THEMELOR

Kapitali i shoqërisë "KRYPA" SH.P.K do të jetë 300.000 lekë i ndarë në 1 kuote.  
Themeluesi ka të drejtë të zmadhojë ose të zvoglojë kapitalin e shoqërisë në natyrë dhe në para në përputhje me statusin e shoqërisë. Kapitali themelore i shoqërisë i ndarë në **kuota në para** është nënshkruar nga themeluesi si më poshtë

1. Ortaku themelues **Z. Ermir Krypa** është mbajtes i 100 % të kuotave të kapitalit themelor

## NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Shoqëria drejtohet organizohet dhe administrohet nga organet e saj që janë Asambleja e Përgjithshme me një administrator.

### Neni 7 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është organi vendimorë i shoqërisë dhe merr vendime me të rëndësishme për ecurinë e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme përbehet nga ortaket e shoqërisë.

### Neni 8 ADMINISTRATORI

Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një administrator i cili do të përbehet nga një antare që do të emrohet nga asambleja e përgjithshme për një periudhë 5 vjeçare. Statusi i shoqërisë përcakton kompetencat e administratorit.

### Neni 9 VITI FINANCIAR

Viti i parë financiar do të fillojë me rregjistrimin e shoqërisë në regjistrin Tregëtarë të QKB .

### Neni 10 MOSMARRVESHJET

Për cdo mosmarrveshje e lindur në kuadrin ose për shkak të kesajë kontratë çështja i paraqitet Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhë duke gjykuar mbi bazën e ligjeve shqiptare.

### Neni 11 SHOQËRIA ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR PRISHET

Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

Me vendim të asamblese së përgjithëshme .

Me hapjen e procedurave të falimentimit.

Nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtarë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarsë në përputhje me ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit", neni 43, pika 3. Me Vendim të Gjykatës .

Për arsye të tjera të parashikuara në statut.

### Neni 12 DISPOZITA E FUNDIT


Të gjitha shpenzimet që do të kryhen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përshihen në bilancin ekonomik të shoqërisë.

Ky akte themelim përbehet nga 12 nene. Ai është përgaditur në 4 kopje në gjuhën shqipe.

Ky akte themelimi u shkrua, u lexua u firmos me vullnetin e lirë e të plote nga ortaket themelues të shoqërisë, në datën e sotme .

**ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË**

**ADMINISTRATORI**

ERMIR KRYPA  


ERMIR KRYPA  
